



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P 27/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.01.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Modifikimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit “*Kërkesë për Propozime*” me Nr. REF-37880-12-13-2017 me objekt: “*Blerje matësa uji*”, me fond limit 3,000,000 lekë pa tvsh, e parashikuar për tu zhvilluar në datën 26.12.2017, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kavajë.

**Ankimues:**

“Mega Plast” 2L shpk  
Rruga “Ferit Xhajko”, Ambjenti Nr.3/520 Tregu Uzina  
Dinamo Tiranë

**Autoriteti Kontraktor**

Ujësjetllës Kanalizime Kavajë  
Rr.Taulantja, nr 2 Kavaje

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për Miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 14.12.2017 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*” me Nr. REF-37880-12-13-2017 me objekt: “*Blerje matësa uji*”, me fond limit 3,000,000 lekë pa tvsh, e parashikuar për tu zhvilluar në datën 26.12.2017, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Kavajë.

II.2. Në datën 19.12.2017 operatori ekonomik “Mega Plast 2L” sh.p.k, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

- *Tek kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 2.3 kapaciteti teknik keni kërkuar që:  
2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar për sistemin e menaxhimit të cilësisë me certifikatë ISO 9001:2008 për importin e mallrave objekt prokurimi. Në rastin kur Operatori Ekonomik është prodhues i mallrave objekt prokurimi, ai duhet të paraqesë certifikatë ISO 9001:2008 si për prodhimin dhe tregtimin e mallrave objekt prokurimi.*

**2.3.4** *Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë dhe shëndetit me certifikatë OHSAS 18001:2007 për tregtimin e mallrave objekt prokurimi. Në rastin kur Operatori Ekonomik është prodhues i mallrave objekt prokurimi, ai duhet të paraqesë certifikatën OHSAS 18001:2007 për prodhimin dhe tregtimin e mallrave objekt prokurimi.*

**2.3.5** *Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar për sistemin e menaxhimit të ambientit me certifikatë ISO 14001:2004 për tregtimin e mallrave objekt prokurimi. Në rastin kur Operatori Ekonomik është prodhues i mallrave objekt prokurimi, ai duhet të paraqesë certifikatën ISO 14001:2004 për prodhimin dhe tregtimin e mallrave objekt prokurimi.*

*Në brendësi të këtyre tre kërkesave keni përcaktuar që operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë të treja këto certifikata ku në objektin e tyre të përcaktohet importimi ose tregëtimi i mallrave objekt prokurimi që në këtë rast janë matsat e ujit dhe aksesoret e tjerë të përcaktuar në preventiv. Në këtë mënyrë kufizoni operatorët e tjerë ekonomikë që kanë të njëjtat certifikata por që në objektin e tyre mund të mos jenë të cilësuar domosdoshmërisht vetëm matsa, vula apo bllokues dhe tregëtimi apo importimi i tyre. Certifikatat e menaxhimit të cilësisë, mjesisit dhe sigurisë në punë janë certifikata që lidhen me fushën e veprimtarisë tregëtuese apo prodhuese që mund të ushtrojë një operator ekonomik dhe jo direkt me një lloj malli që mund të tregëtojë apo prodhojë ai në vecanti pasi veprimtaria tregëtare e një operatori ekonomik mund të jetë shumë më e madhe dhe më e gjërë se sa në tregëtimin e vetëm matsave që kërkoni ju. Në veprimtarinë e tyre tregëtare operatorët ekonomikë mund të ushtrojnë tregëtimin apo importimin e mallrave të ndryshëm industriale, të natyrës elektrike, mekanike, elektronike, veshmbathjeve, ushqimore apo hidraulike në të cilat futen dhe mallrat që ju prokuroni. Do të ishte më e saktë dhe më e drejtë nga ana juaj në kërkesat tuaja të cilësohej që: Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatë ISO 9001:2008, OHSAS 18001:2007, 14001:2004 objekti i të cilave lidhet me tregëtimin e mallrave të natyrës hidraulike në të cilën përfshihen dhe mallrat objekt prokurimi, Në këtë mënyrë kërkesa do të ishte e qartë, nuk do të linte vend për interpretim, nga ana juaj që mund të bëhet shkak për skualifikim të OE, do të ishte gjithëpërfshirëse, jo kufizuese, dhe jo diskriminuese për të gjithë operatorët ekonomikë që i disponojnë këto certifikata por jo vetëm për mallrat që ju kërkoni.*

- *Tek kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 2.3 kapaciteti teknik keni kërkuar që:*

**2.3.8** *Operatori ekonomik per vulat e ofruara duhet te paraqese: Certificate qe verteton se nuk kane permbajtje materjalesh toksike dhe nuk jane te demshme per perdoruesin; Raport testimi qe eshte ne perputhje me standartin ISO 527-2; Certificate qe te vertetoje se eshte rezistente ndaj rrezeve UV. Te gjitha keto certifikata te jene te leshuara nga institucione kompetente te pavarura certifikues/testues.*

*Lidhur me këtë pikë keni kërkuar që të paraqiten 2 certifikata dhe një raport testimi në përputhje me standartin ISO 527-2 por nuk cilësoni çfarë certifikatash apo dokumentash janë ato. Nëse kërkoni certifikata testimi, eksaminimi apo konformiteti në këtë rast kërkesa për paraqitjen e raportit të testimit do të ishte e tepërt pasi cdolloj certifikate e kësaj natyre që konfirmon mospërmbajtjen e materialeve toksike, rezistencën ndaj rrezeve UV dhe që nuk janë të dëmshme jepet dhe lëshohet bazuar në testimet e kryera më parë kështu që në thelb janë e njëjta gjë. Gjithashtu në varësi të vendit të origjinës dhe vendit dhe organit certifikues të treja këto kërkesa që ju keni mund të jenë të përfshira në një lloj certifikate në*

përputhje me ISO-n që ju keni vendosur apo ekuivalentin e tij në vendin e certifikimit pasi dihet që cdo vend ku lëshohet certifikata aplikon standartet e vendit të tij të nxjerra në përputhje me direktivat europiane cka e bën të domosdoshme që nga ana juaj të përcaktohet për cdo certifikatë apo dokument ose standart që cilësoni të shtohet ose ekuivalenti i tij/saj.

- Tek kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 2.3 kapaciteti teknik keni kërkuar që:  
**2.3.11** Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të tij një inxhinier mekanik dhe kjo të vërtetohet me listëpagesët e shoqërisë për 6 muajt e fundit, kontratën e punës dhe diplomën e tij.

Nuk e kuptojmë se çfarë lidhje ka kjo kërkesë me objektin e prokurimit i cili që në titull emërtohet Blerje Matësash Uji dhe nuk lidhet me vendosje apo kryerjen e ndonjë punimi specifik. As në specifikimet teknike, as në preventiv dhe në ansjë pjesë tjetër të dokumentave standarte të tenderit nuk cilësohen zëra për kryerje punimesh apo vendosje të materialeve që të mund të justifikojë vendosjen e kësaj kërkesë për një inxhinier e aq më tepër mekanik. Ky tender ka lidhje vetëm me blerje malli pra kushdo qoftë operatori fitues ka si detyrim vetëm furnizimin me mallrat objekt prokurimi sipas specifikave të vendosura nga AK dhe për këtë nuk nevojitet inxhinier i asnjë lloji nga ana e OE. Inxhinierin duhet ta disponojë AK juaj që merr mallin në dorëzim dhe jo OE. Sa më sipër kërkojmë heqjen e kriterit.

- Tek kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 2.3 kapaciteti teknik keni kërkuar që:  
**2.3.10** Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për mallin objekt prokurimi, i cili duhet të jetë në përputhje të plotë me specifikimet teknike. Produkti duhet të jetë i verifikueshëm në faqen online të prodhuesit.

Në lidhje me këtë pikë kundërshtojmë kërkesën që keni vendosur që produkti duhet të jetë i verifikueshëm në eeb-in e prodhuesit pasi faqet zyrtare të prodhuesve menaxhohen nga vetë ata të cilët në cdo moment mund të heqin apo të shtojnë të dhëna nga eëbsitet. Deri në ditën e hapjes së ofertave ose shpalljen e renditjen përfundimtare të ofertuesve ekziston mundësia që produktet, të dhënat, dokumentat e shpallura në faqet zyrtare të prodhuesve të fshihen, zëvendësohen, tjetërsohen, shtohen dhe në disa raste mund të mbyllet si faqe. Kjo nuk varet nga OE dhe si e tillë nuk ka se si të jetë kërkesë për kualifikim në DT apo objekt skualifikimi. Prodhuesi mund ti ketë ose jo të shpallura të gjitha produktet e tij në faqe , mund ti rifreskojnë produktet,ti ndryshojnë ato sa në momentin që ju doni të verifikoni një produkt mund të mos ekzistojë orën apo ditën tjetër. Mendojmë që këto kritere që nuk janë në dorën tonë për ti menaxhuar as kontrolluar të mos përfshihen në këto kushte.

- Tek kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 2.3 kapaciteti teknik keni kërkuar që:  
**2.3.9** Operatori ekonomik, në datën dhe orën e hapjes së ofertave, duhet të paraqesë mostra të mallrave objekt prokurimi, te cilat duhet të jene ne përputhje me specifikimet teknike.Mosdorëzimi i mostrave në momentin e hapjes së ofertave, është kusht për skualifikim.

Ju kërkon mostra ditën dhe orën e hapjes së ofertave në një kohë që një kërkesë e tillë aq më tepër në një periudhë të tillë duhet të vendoset vetëm për operatorin që shpallet fitues. Nuk e kuptojmë venien e kësaj kërkesë përveç se të selektojë dhe të skualifikojë ata operatorë që nuk dërgojnë mostra çfarë qëllimi ka në këtë fazë pasi edhe nëse operatorët ekonomikë i sjellin mostrat edhe pse mund të mos jenë fiks me specifikimet tuaja apo mund

*të jenë me parametra më të mira se ato që keni vendosur kjo për ju mund të interpretohet si kusht skualifikues. Mosparaqitja e mostrave në asnjë rast dhe në asnjë paragraf të ligjit nuk cilësohet që ju mund ta përdorni si kriter skualifikues pasi në këtë fazë rëndësi kanë dokumentat e paraqitura dhe vlera e ofertës pavarësisht nëse janë sjellë ose jo mostrat dhe nëse janë fiks ashtu si i doni ju. Detyrimi për paraqitje mostrash duhet të jetë vetëm për operatorin e shpallur fitues pasi do të jetë ai që do të përmbuhsë kontratën dhe dërgojë mallrat. Kërkojmë ndryshimin e kriterit duke e bërë atë detyrues vetëm për OE e shpallur fitues dhe jo për pjesmarrësit e tjerë.*

II.3. Në datën 28.12.2017 me shkresën nr.1747/1 prot, autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.4. Në datën 28.12.2017 pala ankimuese “Mega Plast 2L” sh.p.k., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr.01/1 prot., datë 05.01.2018 protokolluar me tonën me nr.1902/2 datë 09.01.018 me objekt “Dërgohet informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Mega Plast 2L” shpk për modifikimin e kriterit “**2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar për sistemin e menaxhimit të cilësisë me çertifikatë ISO 9001:2008 për importin e mallrave objekt prokurimi. Në rastin kur Operatori Ekonomik është prodhues i mallrave objekt prokurimi, ai duhet të paraqesë çertifikatë ISO 9001:2008 si për prodhimin dhe tregtimin e mallrave objekt prokurimi; 2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë dhe shëndetit me çertifikatë OHSAS 18001:2007 për tregtimin e mallrave objekt prokurimi. Në rastin kur Operatori Ekonomik është prodhues i mallrave objekt prokurimi, ai duhet të paraqesë çertifikatën OHSAS 18001:2007 për prodhimin dhe tregtimin e mallrave objekt prokurimi; 2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar për sistemin e menaxhimit të ambientit me çertifikatë ISO 14001:2004 për tregtimin e mallrave objekt prokurimi. Në rastin kur Operatori Ekonomik është prodhues i mallrave objekt prokurimi, ai duhet të paraqesë çertifikatën ISO 14001:2004 për prodhimin dhe tregtimin e mallrave objekt prokurimi.**

*Në brendësi të këtyre tre kërkesave keni përcaktuar që operatorin ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë të treja këto certifikata ku në objektin e tyre të përcaktohet importimi ose tregtimi i mallrave objekt prokurimi që në këtë rast janë matsat e ujit dhe aksesoret e tjerë të përcaktuar në*

preventiv. Në këtë mënyrë kufizoni operatorët e tjerë ekonomikë që kanë të njëjtat certifikata por që në objektin e tyre mund të mos jenë të cilësuar domosdoshmërisht vetëm matsa, vula apo bllokues dhe tregëtimi apo importimi i tyre. Certifikatat e menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë në punë janë certifikata që lidhen me fushën e veprimtarisë tregëtuese apo prodhuese që mund të ushtrojë një operator ekonomik dhe jo direkt me një lloj malli që mund të tregëtojë apo prodhojë ai në vecanti pasi veprimtaria tregëtare e një operatori ekonomik mund të jetë shumë më e madhe dhe më e gjërë se sa në tregëtimin e vetëm matsave që kërkoni ju. Në veprimtarinë e tyre tregëtare operatorët ekonomikë mund të ushtrojnë tregëtimin apo importimin e mallrave të ndryshëm industriale, të natyrës elektrike, mekanike, elektronike, veshmbathjeve, ushqimore apo hidraulike në të cilat futen dhe mallrat që ju prokuroni. Do të ishte më e saktë dhe më e drejtë nga ana juaj në kërkesat tuaja të cilësohej që: Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatë ISO 9001:2008, OHSAS 18001:2007, 14001:2004 objekti i të cilave lidhet me tregëtimin e mallrave të natyrës hidraulike në të cilën përfshihen dhe mallrat objekt prokurimi, Në këtë mënyrë kërkesa do të ishte e qartë, nuk do të linte vend për interpretim, nga ana juaj që mund të bëhet shkak për skualifikim të OE , do të ishte gjithëpërfshirëse, jo kufizuese, dhe jo diskriminuese për të gjithë operatorët ekonomikë që i disponojnë këto certifikata por jo vetëm për mallrat që ju kërkoni”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

**2.3.2** Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar për sistemin e menaxhimit të cilësisë me certifikatë ISO 9001:2008 për importin e mallrave objekt prokurimi. Në rastin kur Operatori Ekonomik është prodhues i mallrave objekt prokurimi, ai duhet të paraqesë certifikatë ISO 9001:2008 si për prodhimin dhe tregëtimin e mallrave objekt prokurimi;

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë dhe shëndetit me certifikatë OHSAS 18001:2007 për tregëtimin e mallrave objekt prokurimi. Në rastin kur Operatori Ekonomik është prodhues i mallrave objekt prokurimi, ai duhet të paraqesë certifikatën OHSAS 18001:2007 për prodhimin dhe tregëtimin e mallrave objekt prokurimi;

**2.3.5** Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar për sistemin e menaxhimit të ambientit me certifikatë ISO 14001:2004 për tregëtimin e mallrave objekt prokurimi. Në rastin kur Operatori Ekonomik është prodhues i mallrave objekt prokurimi, ai duhet të paraqesë certifikatën ISO 14001:2004 për prodhimin dhe tregëtimin e mallrave objekt prokurimi.

III.1.2. Në shtojcën 10 “Sasia dhe Grafiku i Lëvrimit”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Sasia e mallit që mund të kërkohet:

1. Matesa Uji ½ 1 500 (njemijepesqind) cope
2. Vula per matesa uji 1 500 (njemijepesqind) cope
3. Bllokues per saracineska 100 (njeqind) cope

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-se përcakohet se: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit."*

III.1.4. Në nenin 46, pika 2 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *"[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. [...]"*

III.1.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 30 “Kërkesat e cilësisë”, përcaktohet se:

*"1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit."*

*2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit".*

III.1.6. Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: *"Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik";*

*"Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:*

*a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;*

*b) transparencë në procedurat e prokurimit;*

*c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve",*

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.1.8. Referuar pretendimeve të ankimesit, argumenteve të autoritetit kontraktor si dhe objektit të prokurimit, Komisioni konstaton se objekti i prokurimit ka të bëjë me mallra të tillë si matësa uji, vula për matësa uji dhe bllokues saracineske, të cilat në një kuptim më të gjërë përfshihen në grupin e materialeve hidraulike. KPP gjykon se objekti i veprimtarisë së një shoqërie tregëtare i

pasqyruar në certifikatat e cilësisë së sipërcituara mund të kenë një karakter dhe formulim të përgjithshëm dhe nuk mund të përfshijë të gjitha emërtimet konkrete të objekteve të një procedurë prokurimi sikundër argumenton autoriteti kontraktor. Në këtë kuadër Komisioni gjykon se nuk është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë të përcaktuar në mënyrë eksplicite objektin e prokurimit në certifikatat e tyre të cilësisë pasi certifikatat nuk lëshohen për një objekt në vecanti e rrjedhimisht kjo kërkesë është joproportionale me përmasat e kontratës dhe nuk është e lidhur aspak me natyrën dhe aftësinë zbatuese të saj. Ashtu sikundër ka argumentuar edhe ankimesi në parashtrimet me shkrim në ankesë certifikatat e menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë në punë janë certifikata që lidhen me fushën e veprimtarisë tregëtuese apo prodhuese që mund të ushtrojë një operator ekonomik dhe jo direkt me një lloj malli që mund të tregëtojë apo prodhojë ai në vecanti, pasi veprimtaria tregëtare e një operatori ekonomik mund të jetë shumë më e madhe dhe më e gjërë se sa në tregtimin e vetëm matësive që kërkon autoriteti kontraktor. Në veprimtarinë e tyre tregtare operatorët ekonomikë mund të ushtrojnë tregtimin apo importimin e mallrave të ndryshëm industriale, të natyrës elektrike, mekanike, elektronike, veshmbathjeve, ushqimore apo hidraulike në të cilat futen dhe mallrat që autoriteti prokuron.

Në këtë kuptim, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor në hartimin e kriterëve të vecanata të kualifikimit duhet të ketë parasysh elementë të tilla si mosdiskriminimi, proporcionaliteti, dobishmëria dhe nevoja, të gjitha në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret vendosja e kriterit për përshkrimin në certifikatat e cilësisë ekzaktësisht, të objektit konkret të prokurimit, nuk diktohet nga nevoja për realizimin me sukses të kontratës, pasi cdo shoqëri e cila operon në fushën e tregtimit apo prodhimit të materialeve të ndryshme hidraulike, në të cilat përfshihen dhe mallrat objekt prokurimi, ka të drejtë të konkurojë për procedurën e prokurimit objekt ankimi. KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masat e nevojshme për modifikimin e kriterit në përputhje me pretendimet e ankimesit.

Sa më sipër pretendimi i ankimesit qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Mega Plast 2L” shpk për modifikimin e kriterit “*2.3.8 Operatori ekonomik per vulat e ofruara duhet te paraqese: Certificate qe verteton se nuk kane permbajtje materjalesh toksike dhe nuk jane te demshme per perdoruesin; Raport testimi qe eshte ne perputhje me standartin ISO 527-2; Certificate qe te vertetoje se eshte rezistente ndaj rrezeve UV. Te gjitha keto certifikata te jene te leshuara nga institucione kompetente te pavarura certifikues/testues. Lidhur me këtë pikë keni kërkuar që të paraqiten 2 certifikata dhe një raport testimi në përputhje me standartin ISO 527-2 por nuk cilësoni cfarë certifikatash apo dokumentash janë ato. Nëse kërkon certifikata testimi, eksaminimi apo konformiteti në këtë rast kërkesa për paraqitjen e raportit të testimit do të ishte e tepërt pasi cdolloj certifikate e kësaj natyre që konfirmon mospërmbajtjen e materialeve toksike , rezistencën ndaj rrezeve UV dhe që nuk janë të dëmshme jepet dhe lëshohet bazuar në testimet e kryera më parë kështu që në thelb janë e njëjta gjë. Gjithashtu në varësi të vendit të origjinës dhe organit certifikues të treja këto kërkesa që ju keni mund të jenë të përfshira në një lloj certifikate në përputhje me ISO-n që ju keni vendosur apo ekuivalentin e tij në vendin e certifikimit pasi dihet që cdo vend ku lëshohet certifikata aplikon standartet e vendit të tij të nxjerra në përputhje me direktivat europiane cka e bën të domosdoshme që nga ana juaj të përcaktohet për cdo certifikatë apo dokument ose standart që cilësoni të shtohet ose ekuivalenti i tij/saj”, Komisioni i prokurimit Publik vëren se,*



III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- **2.3.8 Operatori ekonomik per vulat e ofruara duhet te paraqese: Certificate qe verteton se nuk kane permbajtje materjalesh toksike dhe nuk jane te demshme per perdoruesin; Raport testimi qe eshte ne perputhje me standartin ISO 527-2; Certificate qe te vertetoje se eshte rezistente ndaj rrezeve UV. Te gjitha keto certifikata te jene te leshuara nga institucione kompetente te pavarura certifikues/testues.**

III.2.2. Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 27 “Kontratat e mallrave”, pika 6 përcaktohet: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

Ndërsa, në nenin 30 “Kërkesat e cilësisë”, pikat 1 dhe 2 përcaktohet: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”.

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.4. Në rastin konkret autoriteti kontraktor ka përcaktuar se në përmbushje të kriterit sa më sipër operatorët ekonomikë, për vulat e ofruara, duhet të paraqesin certifikata që vërtetojnë se nuk kane permbajtje materialesh toksike dhe nuk jane te demshme per perdoruesin, certificate qe te vertetoje se vula eshte rezistente ndaj rrezeve UV, si dhe raport testimi qe vulat jane ne perputhje me standartin ISO 527-2; KPP gjykon se dokumentacioni i kërkuar është në përputhje dhe brenda kuadrit ligjor në fuqi. Ky dokumentacion i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar bindjen se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara. Është në të drejtën e autoritetit kontraktor të kërkojë dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, pra certifikata apo raporte testimi të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të vendosura, përpara se të përzgjedhë shoqërinë fituese të kontratës objekt prokurimi. Akoma më tej referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimesit ky i fundit ka pranuar se

mjafton që dokumentacioni i paraqitur nga operatorët ekonomikë të dëshmojë se plotëson specifikimet teknike të kërkuara pavarësisht se paraqitet një dy apo tre certifikata, si dhe malli i ofruar është në përputhje me standartin ISO 527-2 ose ekuivalentin e tij, dhe do të koniderohet i vlefshëm. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se ankimuesi është sqaruar në lidhje me mënyrën e përmbushjes së kriterit dhe autoriteti kontraktor ka detyrimin të bëjë publike në SPE sqarimin e dhënë, për të gjithë operatorët e tjerë ekonomikë të interesuar për këtë procedurë, në kuptim të nenit 42 të LPP.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Mega Plast 2L” shpk për modifikimin e kriterit “**2.3.11 Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të tij një inxhinier mekanik dhe kjo të vërtetohet me listëpagesët e shoqërisë për 6 muajt e fundit, kontratën e punës dhe diplomën e tij. Nuk e kuptojmë se çfarë lidhje ka kjo kërkesë me objektin e prokurimit i cili që në titull emërtohet Blerje Matësash Uji dhe nuk lidhet me vendosje apo kryerjen e ndonjë punimi specifik. As në specifikimet teknike, as në preventiv dhe në asnjë pjesë tjetër të dokumentave standarte të tenderit nuk cilësohen zëra për kryerje punimesh apo vendosje të materialeve që të mund të justifikojë vendosjen e kësaj kërkesë për një inxhinier e aq më tepër mekanik. Ky tender ka lidhje vetëm me blerje malli pra kushdo qoftë operatori fitues ka si detyrim vetëm furnizimin me mallrat objekt prokurimi sipas specifikave të vendosura nga AK dhe për këtë nuk nevojitet inxhinier i asnjë lloji nga ana e OE. Inxhinierin duhet ta disponojë AK juaj që merr mallin në dorëzim dhe jo OE. Sa më sipër kërkojmë heqjen e kriterit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,**

III.3.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

- **2.3.11 Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të tij një inxhinier mekanik dhe kjo të vërtetohet me listëpagesët e shoqërisë për 6 muajt e fundit, kontratën e punës dhe diplomën e tij.**

III.3.2. Në nenin 27 “Kontratat e mallrave” të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, janë përcaktuar dokumentacioni dhe dëshmitë që duhet të kërkojë autoriteti dhe të dorëzojë operatori ekonomik për të vërtetuar se disponon kapacitetet e nevojshme dhe të mjaftueshme për realizimin e kontratës në përputhje dhe me volumin e saj.

Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.

III.3.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ligjvënësi ka mirëpërcaktuar në rregullat e prokurimit publik, dokumentacionin dhe dëshmitë që duhet të dorëzojë operatori ekonomik për të vërtetuar se disponon kapacitetet e nevojshme dhe të mjaftueshme për realizimin e kontratës për procedurat e prokurimit “Blerje Mallra” të tilla si, dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit financiare, kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, kopje të deklaratave të xhiros vjetore dhe/ose deklaratë për gjendjen financiare nga një ose më shumë banka.

III.3.4. Gjithashtu mund të kërkohen dëshmi për origjinalitetin e mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike dhe/ose dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Në asnjë dispozitë të ligjit, në lidhje me këtë lloj procedure prokurimi (*blerje mallrash*) nuk lihet hapësirë për autoritetet që të kërkojnë staf teknik, sikundër është përcaktuar në dokumentat e tenderit në rastin konkret, përvec rasteve kur përvec furnizimit të mallrave autoriteti kërkon edhe veprimtari instalimi në kuptim të nenit 44 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Në rastet e kontratave publike për shërbime apo punë, si dhe të kontratave publike të furnizimit për shërbime shtesë dhe/ose veprimtari instalimi, autoritetet kontraktore mund t'u kërkojnë personave juridikë të paraqesin në ofertë ose në kërkesën për pjesëmarrje emrat dhe kualifikimet profesionale përkatëse të personelit përgjegjës për zbatimin e kontratës në fjalë.*

Në rastin konkret KPP konstaton se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorit ekonomik të një inxhinier mekanik nuk justifikohet pasi referuar specifikimeve teknike, sasisë dhe grafikut të lëvrimit, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi nuk përcaktohen zëra të tillë për kryerje punimesh apo vendosje të mallrave objekt prokurimi. Në këtë kuptim KPP gjykon se, në kushtet kur është vetë autoriteti kontraktor, i cili do të bëjë implementimin/vendosjen e matësave të ujit, vulave dhe saracineskave, nuk është e nevojshme që operatorët ekonomik pjesmarrës të disponojnë në stafin e tyre një inxhinier mekanik.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Mega Plast 2L” shpk për modifikimin e kriterit “**2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për mallin objekt prokurimi, i cili duhet të jetë në përputhje të plotë me specifikimet teknike. Produkti duhet të jetë i verifikueshëm në faqen online të prodhuesit. Në lidhje me këtë pikë kundërshtojmë kërkesën që keni vendosur që produkti duhet të jetë i verifikueshëm në ëeb-in e prodhuesit pasi faqet zyrtare të prodhuesve menaxhohen nga vetë ata të cilët në cdo moment mund të heqin apo të shtojnë të dhëna nga ëeb-sitet. Deri në ditën e hapjes së ofertave ose shpalljen e renditjen përfundimtare të ofertuesve ekziston mundësia që produktet, të dhënat, dokumentat e shpallura në faqet zyrtare të prodhuesve të fshihen, zëvendësohen, tjetërsohen, shtohen dhe në disa raste mund të mbyllet si faqe. Kjo nuk varet nga OE dhe si e tillë nuk ka se si të jetë kërkesë për kualifikim në DT apo objekt skualifikimi. Prodhuesi mund ti ketë ose jo të shpallura të gjitha produktet e tij në faqe , mund ti rifreskojnë produktet, ti ndryshojnë ato sa në momentin që ju doni të verifikoni një produkt mund të mos ekzistojë orën apo ditën tjetër. Mendojmë që këto kritere që nuk janë në dorën tonë për ti menaxhuar as kontrolluar të mos përfshihen në këto kushte”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,**

III.4.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

- **2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për mallin objekt prokurimi, i cili duhet të jetë në përputhje të plotë me specifikimet teknike. Produkti duhet të jetë i verifikueshëm në faqen online të prodhuesit.**

III.4.2. Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 27 “Kontratat e mallrave”, pika 6 përcaktohet “Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë

operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.4.3. Referuar sa më sipër, KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e katalogëve të prodhuesit për mallrat objekt prokurimi është në përputhje me dispozitat ligjore. Sa i takon kërkesës së autoritetit kontraktor që produkti të jetë i verifikueshëm në faqen online të prodhuesit, KPP e gjen këtë kërkesë të ekzagjeruar, diskriminuese dhe jo të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit. Argumentat e ankimesit se faqet zyrtare të prodhuesve menaxhohen nga vetë ata, të cilët në cdo moment mund të heqin apo të shtojnë të dhëna nga ëbsitet, kjo nuk varet nga OE dhe si e tillë nuk ka se si të jetë kërkesë për kualifikim në DT apo objekt skualifikimi KPP i gjen të tërësisht të drejta pasi operatori ekonomik nuk mund të mbajë përgjegjësi për mungesën e një produkti apo malli në këto faqe në kushtet kur në katalogët e dorëzuar mund të gjenden të plota të dhënat dhe specifikimet e produktit në fjalë. KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk mund të kushtëzojë dhe të penalizojë operatorët ekonomikë me kriteret të tilla të cilat nuk mund të përmbushen nga ofertuesit jo për faj të tyre. KPP gjykon se është tërësisht e mjaftueshme kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e katalogëve të prodhuesve në funksion të verifikimit të përpueshmërisë së produkteve me specifikimet teknike. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masat për modifikimin e kriterit duke hequr frazën *Produkti duhet të jetë i verifikueshëm në faqen online të prodhuesit*.

Sa më sipër pretendimi i ankimesit qëndron

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Mega Plast 2L” shpk për modifikimin e kriterit “2.3.9 Operatori ekonomik, në datën dhe orën e hapjes së ofertave, duhet të paraqesë mostra të mallrave objekt prokurimi, të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike. Mosdorëzimi i mostrave në momentin e hapjes së ofertave, është kusht për skualifikim. Ju kërkoni mostra ditën dhe orën e hapjes së ofertave në një kohë që një kërkesë e tillë aq më tepër në një periudhë të tillë duhet të vendoset vetëm për operatorin që shpallet fitues. Nuk e kuptojmë venien e kësaj kërkesë përveç se të selektojë dhe të skualifikojë ata operatorë që nuk dërgojnë mostra afarë qëllimi ka në këtë fazë pasi edhe nëse operatorët ekonomikë i sjellin mostrat edhe pse mund të mos jenë fiks me specifikimet tuaja apo mund të jenë me parametra më të mira se ato që keni vendosur kjo për ju mund të interpretohet si kusht skualifikues. Mosparaqitja e mostrave në asnjë rast dhe në asnjë paragraf të ligjit nuk cilësohet që ju mund ta përdorni si kriter skualifikues pasi në këtë fazë rëndësi kanë dokumentat e paraqitura dhe vlera e ofertës pavarësisht nëse janë

*sjellë ose jo mostrat dhe nëse janë fiks ashtu si i doni ju. Detyrimi për paraqitje mostrash duhet të jetë vetëm për operatorin e shpallur fitues pasi do të jetë ai që do të përmbuhsë kontratën dhe dërgojë mallrat. Kërkojmë ndryshimin e kriterit duke e bërë atë detyrues vetëm për OE e shpallur fitues dhe jo për pjesmarrësit e tjerë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.5.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

- *2.3.9 Operatori ekonomik, në datën dhe oren e hapjes së ofertave, duhet të paraqesë mostra të mallrave objekt prokurimi, të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike. Mosdorëzimi i mostrave në momentin e hapjes së ofertave, është kusht për skualifikim.*

III.5.2. Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 27 “Kontratat e mallrave”, pika 6 përcaktohet “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

*a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

*b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose*

*c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.5.3. Komisioni gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.5.4. Në interpretimin teleologjik (qëllimit) të dispozitës së sipërcituar, KPP gjykon se, qëllimi i vendosur nga ligjvënësi për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë së autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuar nga autoriteti kontraktor në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit. Në rastin konkret, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor ka kërkuar mostra për produktet e prokuruarat të cilat nuk janë të ekzagjeruara në numër, pasi vetë sasia e kërkuar në këtë procedurë prokurimi është vetëm për 3 artikuj dhe dorëzimi i mostrave është i rëndësishëm për autoritetin kontraktor në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së specifikimeve teknike me mostrat e dorëzuara, me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Sa më sipër KPP gjykon se paraqitja e mostrave është në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara, proporcionale me objektin e prokurimit dhe lehtësisht e mundur për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të pranojë pjeserisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Mega Plast 2L” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-37880-12-13-2017 me objekt: “Blerje matësa uji”, me fond limit 3,000,000 lekë pa tvsh, e parashikuar për tu zhvilluar në datën 26.12.2017, nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Kavajë.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentat e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Mega Plast 2L” sh.p.k
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1902 Protokoli, Datë 28.12.2017**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Zv/Kryetar**  
**Leonard Gremshi**

**Anëtar**  
**Kleves Janku**

**Anëtar**  
**Odise Moçka**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**